

**V E N D I M**  
**Nr.198, datë 4.5.1993**

**PËR KRIJIMIN E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I :**

1. Krijimin e Entit Kombëtar të Banesave si person juridik me qendër në Tiranë, në bazë të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet". Enti është në vartësi të Ministrisë së Ndërtimit të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

Enti Kombëtar i Banesave do të realizojë financimin, ndërtimin dhe administrimin e banesave në Republikën e Shqipërisë".

2. Enti Kombëtar i Banesave ka këto detyra e të drejta:

- a) financimi dhe lidhja e kontratave për ndërtimin, përfundimin dhe shitjen e banesave;
- b) përcaktimi dhe zbatimi i kushteve për ndërtimin dhe përfundimin e banesave;
- c) zbatimi i procedurave të konkurrimit për përzgjedhjen e ndërmarrjeve, me të cilat do të lidhen kontratat për ndërtimin dhe përfundimin e banesave, në përputhje me dispozitat përkatëse;
- ç) zhvillimi i bisedimeve dhe lidhja e marrëveshjeve për kërkim fondesh për realizimin e veprimtarisë, me kushtet e përcaktuara nga këshilli drejtues;

d) zgjidh problemet e huave për blerësit, duke përfshirë edhe individët privatë, për banesa të përfunduara me fondet e siguruar nga Enti;

dh) bashkëpunimi me rrethet, bashkitë e komunat, si dhe me organizma të tjerë të Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit për plotësimin e detyrimeve të tyre në sektorin e banesave;

e) përfaqësimi i shtetit në marrëdhëniet e bashkëpronësisë në banesa, në rastet kur shteti do të vazhdojë të jetë pronar i tyre;

ë) zbaton normativat e strehimit që miratohen nga Këshilli i Ministrave për ndërtimin e banesave.

3. Këshilli drejtues përbëhet nga 7 anëtarë që emërohen nga Ministria e Ndërtimit, e Strehimit dhe e Rregullimit të Territorit (4 anëtarë), si dhe nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Ministria e Punës, e Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë dhe Banka e Shqipërisë (nga 1 anëtar secila).

Kryetari i këshillit drejtues do të jetë drejtori i drejtorisë së strehimit në Ministrinë e Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

Ministri i Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit zgjedh drejtorin e përgjithshëm midis të paktën 2 kandidaturave të paraqitura nga këshilli drejtues.

Drejtori i përgjithshëm do të zbatojë të drejtat dhe detyrimet e Entit, si dhe do të kryejë funksionet administrative të tij. Në bazë të propozimeve të drejtorit të përgjithshëm, këshilli drejtues miraton caktimin e kryetarëve të degëve të Entit në rrethe.

Vendimet e këshillit drejtues janë të detyrueshme për drejtorin e përgjithshëm dhe administratën e Entit Kombëtar të Banesave.

4. Për plotësimin e detyrave dhe të drejtave të tij, Enti mund të sigurojë dhe investojë fonde nga këto burime:

- a) të ardhura që i caktohen Entit nga buxheti shtetëror dhe lokal;
- b) të ardhura nga huatë dhe kreditë e institucioneve financiare vendase e të huaja;
- c) të ardhura nga donatorë vendas ose të huaj;
- ç) të ardhura të realizuara nga investimi i fondeve të vetë Entit;
- d) të ardhura nga privatizimi i banesave shtetërore;
- dh) të ardhura nga shitja e banesave;
- e) të ardhura të tjera dhe pasuri të luajtshme e të paluajtshme që mund të sigurojë Enti.

5. Kapitali fillestar i Entit Kombëtar të Banesave është 5 milionë lekë nga fondi rezervë i caktuar nga Këshilli i Ministrave në vitin 1992.

6. Llogaritë vjetore të Entit do të kontrollohen e vërtetohen nga specialistë kontabël të pavarur, në përputhje me ligjin "Për ndërmarrjet".

Llogaritë vjetore të kontrolluara dhe relacioni për veprimtarinë financiare vjetore, i miratuar nga këshilli drejtues, i dërgohet Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit dhe Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë.

Ky dokument do t'i dërgohet edhe institucioneve vendase e të huaja që i kanë akorduar hua, kredi ose donacione Entit Kombëtar të Banesave, me kërkesën e tyre.

7. Statuti dhe akte të tjera që rregullojnë funksionimin e Entit Kombëtar të Banesave dhe të degëve të tij, miratohen nga ministri i Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

8. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.431, datë 12.10.1992, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**